



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:277353

Datë: 22.10.2024

Numri i dokumentit: 06366725

KF.nr.497/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, dhe zyrtaren ligjore Arta Hyseni, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “Sh.K.” B.I me NUI 810446808 dhe seli në rr. “Lidhja e Prizrenit” nr.48 në Prishtinë, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit – rivlerësim tatimor, vlera e kontestit 51,376.50€, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor- publik, të mbajtur me datë 09.10.2024 në prani të përfaqësueses së autorizuar të paditësit Ilire Tasholli Aydogan, avokate nga Prishtina, e në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Sh.K.” B.I me seli në Prishtinë.
- II. ANULOHET pjesërisht vendimi nr.350/2021 i datës 11.11.2021, i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës, vetëm sa i përket trajtimit të huazimeve dhe deponimeve në llogaritë bankare nga ana e kontrollit tatimor dhe lënda për këtë pjesë kthehet në RISHQYRTIM DHE RIVENDOSJE tek e paditura.
- III. MBETET NË FUQI vendimi nr.350/2021 i datës 11.11.2021 i Departamentit të Ankesave të ATK-së në pjesën jokontestuese sa i përket vlerësimeve tjera tatimore që rrjedhin nga Raporti i Kontrollit i datës 13.07.2021.
- IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 09.12.2021 ka iniciuar kontestin tregtar-administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr.350/2021 të datës 11.11.2021 me pretendimin se e paditura me vendimin kontestues dhe Njoftim rivlerësimet nga Kontrolli, gjatë trajtimit të të ardhurave nga interesi në huadhënie, duke u bazuar në nenin 19 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2016 për Zbatimin e Ligjit nr.05/L-028 për tatim në të Ardhura të Korporatave, ka konstatuar se kontrata e paraqitur nga paditësi nuk i plotësojnë të gjitha kriteret e parapara sipas dispozitave të Udhëzimit Administrativ të lartcekur, dhe huazimet i ka trajtuar si të ardhura për paditësin duke pas parasysh se paditësi huazimet të cilat i ka marr, nuk ka filluar ende procesin e kthimit. E paditura ka bërë shkelje të dispozitave materiale, dispozitave të Ligjit nr.04/L-077 sepse në rastin konkret paditësi, në bazë të nenit 51 paragrafi 2 dhe 3, mundet në çdo moment që të bëjë plotësimin dhe ndryshimin e kontratave , por që nuk është në kundërshtim me qëllimin për të cilin është parashikuar forma. Me dispozitën e Ligjit nr.04/L-077 neni 567 lidhur me nenin 572 paragrafi 2 dhe nenit 568, me kontratën e huas, huadhënësi obligohet t'ia dorëzoj huamarrësit një shumë të caktuar të hollash ose sasinë e caktuar të sendeve tjera të zëvendësueshme, ndërsa huamarrësi obligohet ta kthej pas një kohe të caktuar të njëjtën shumë të hollash, përkatësisht të njëjtën sasi sendesh të llojit dhe cilësisë së njëjtë. Palët kontraktuese nëse nuk kanë caktuar afatin për kthimin e huas dhe as që ky mund të caktohet nga rrethanat e huas, huamarrësi ka për detyrë ta kthej huan pasi të ketë kaluar afati i arsyeshëm, duke filluar nga kërkesa e huadhënësit për kthimin e huas. Ndërsa lidhur me nenin 568 huamarrësi mund të obligohet që përveç kryegjësë të debitoj edhe kamatën, që nuk është e obligueshme sipas dispozitave të LMD-së. E paditura në vendimin kontestues, gjatë trajtimit të deponimeve të parasë në llogari bankare të shoqërisë në bankat komerciale të vlerësuara se të gjitha këto deponime janë trajtuar si shitje duke kalkuluar tatimin në vlerën e shtuar, tatimin në fitim për periudhat përkatëse dhe duke bërë kalkulimin e ndëshkimeve dhe interesave për mos pagesë të këtyre tatimeve të vlerësuar mbi vlerat e deponuara nga pazari ditor dhe të deponuara në llogaritë bankare të shoqërisë. E paditura ka bërë dyfishimin e të hyrave të shoqërisë duke trajtuar një herë si shitje me pakicë me kupon fiskal dhe herën e dytë ka njohur si shitje të gjitha deponimet në llogaritë bankare të cilat janë bërë nga arka me shitje me pakicë. Në seancën e shqyrtimit përfaqësuesi i autorizuar i paditësit deklaroi se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë dhe provave të dorëzuara me padi duke shtuar faktin se ligjërisht huaja nuk tatimohet duke pasur parasysh edhe mendimin juridik të Gjykatës Supreme të vitit 2020/2021 të cilin mendim e ka kërkuar vet ATK-ja, andaj mbi bazën e këtyre provave gjykatës i propozon që padinë e paditësit të aprovojë si të bazuar po ashtu mbetet pranë propozimit për ekspertizë si në parashtresën e dorëzuar pranë kësaj gjykate me datë 03.09.2024.

E paditura, në përgjigjen në padi të datës 17.06.2022 i kundërshton në tërësi pretendimet e paraqitura të paditësit si të pabazuara në ligj dhe fakte materiale dhe vlerëson se vendimi i kundërshtuar është i drejtë dhe në harmoni me legjislacionin tatimor të aplikueshëm në Republikën e Kosovës. Tutje deklaron se pretendimet e paditësit lidhur me trajtimin e deponimeve bankare, duke u bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, nuk qëndrojnë për faktin se ky ligj rregullon vetëm të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese por nuk rregullon reflektimet tatimore. Çështja e trajtimit të tatimeve rregullohet me ligje të veçanta dhe kjo e drejtë i jepet ATK-së në bazë të nenit 2 paragrafi 2 të Ligjit 03/L-222 për ATP, njëkohësisht e obligon ATK-në që të administroj çdo lloj tatimi. Duke pasur parasysh nenin 19 par.6 të Ligjit 03/L-222 për ATP, të gjitha deponimet bankare për të cilat pala paditëse nuk ka mundur t'i argumentoj me prova bindëse, ATK i ka trajtuar si të hyra shtesë. Gjatë kontrollit tatimor, paditësi i ka ofruar disa kontrata të huas por këtyre kontratave iu kanë munguar elementet esenciale të tyre siç është afati i kthimit të huas si dhe shkalla e interesit sipas vlerës së hapur. Pretendimi i paditësit së ATK gjatë procedurës administrative nuk ka marr për bazë dokumentacionin e prezantuar nuk ka asnjë mbështetje ligjore dhe faktike. ATK me rastin e njoftimit të paditësit përmes shkresës Dokument i kërkesës së informatave AU003 të datës 02.10.2020 i ka dorëzuar paditësit dhe ka kërkuar dokumentacionin e nevojshëm për kontrollin tatimor. Sipas Raportit të Kontrollës në faqe 8 është përshkruar se paditësi nuk ka pasur libra dhe regjistrime konform nenit 13 të Ligjit 03/L-222 dhe nenit 17 të UA nr.15/2010. Për më tepër ATK gjatë vlerësimit tatimor ka bërë kërkesë specifike duke kërkuar ditarin e arkës edhe përmes emailit zyrtar, por në përgjigjen e datës 14.04.2021 ka theksuar se nuk e posedon ditarin e arkës dhe nuk ka evidencë. Andaj ATK ka analizuar kartelën e bankave BPB, PCB, TEB dhe BKT dhe ka vlerësuar se paditësi për këto deponime bankare nuk ka prezantuar dëshmi për burimin e këtyre mjeteve. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor përfaqësuesi i autorizuar i paditësit deklaron se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi si dhe provat e bashkangjitura. Konsideron se vendimi kontestues është mjaft i qartë në të cilën ATK ka bërë gjatë vlerësimit tatimor dhe kjo vërtetohet përmes përgjigjes të cilën e ka dhënë gjatë fazës së kontrollit të cilën e kemi bashkangjitur në përgjigjen në padi në pikën 10 të provave. Në vet këtë përgjigje të datës 14.04.2021 paditësi ka theksuar se nuk posedon ditarin e arkës, nuk ka evidencë për këto periudha sa i përket për librin kryesor dhe sa i përket tij nuk ka pasur mundësi t'i dorëzoj shënimet e kërkuara konform nenit 15 e të cilët ka qenë i obliguar që ti krijoj në bazë të neni 13 të Ligjit 03/L-222 si dhe nenit 17 të UA 15/2010. Kjo edhe më tepër argumenton faktin se në kontratë për huazim të cilat i ka bashkangjitur paditësi i mungojnë elementet esenciale të cilat parashihen në nenin 19 të UA 01/2016 dhe ligji 05/28 për tatimin në të ardhura personale. Andaj

paditësi nuk ka mundur të argumentoj asnjë pretendim të tij i cili sipas nenit 19 par 6 të Ligjit 03/L-222 barra e provës ka qenë mbi T/P përkatësisht tani paditësin. Andaj kërkon nga gjykata që t'i merr parasysh kundërshtimet e të paditurës si dhe provat e bashkangjitura dhe të merr aktgjykim me të cilin do ta refuzojë padinë si të pabazuar dhe të lë në fuqi vendimin kontestues me nr.350/2021 të datës 11.11.2021.

Gjykata ka shqyrtuar këtë konflikt administrativ në bazë të dispozitave të nenit 41 të LKA-së, për arsye se, në seancë nuk ka prezantuar përfaqësuesi i autorizuar i palës së paditur, mirëpo me parashtresën e datës 26.08.2024 e njëjta e ka njoftuar gjykatën se nuk do të prezantoj në seancë dhe ka kërkuar të veprohet konform nenit 38 paragrafi 5 të LKA-së.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 09.10.2024, ka administruar provat relevante dhe atë: Procesverbal i datës 18.07.2024 me të cilën janë administruar provat si në vijim: Vendimi kontestues nr. 350/2021 dt 11.11.2021, Ankesë në ATK dt 13.09.2021, Raport i kontrollit dt 13.07.2021, Vendimi ZGJONA dt 14.07.2021, Fletat e punës të bashkangjitura në raport të kontrollit, Kontratat mbi huazim: dt 14.11.2019, 18.09.2020, 20.06.2018, 09.08.2018, 14.01.2019, 03.11.2017, 16.11.2019, 29.05.2020, 02.03.2017 së bashku me ekstraktet bankare, Urdhërpagesë e datës 03.07.2018, Email i datës 14.04.2021, Lista e huazimeve, Lista e deponimeve, Libri i arkës periudha 2017, Kartela e kontos për periudhën 2018, 2019 dhe 2020, Historiati i llogarisë-qarkullimi nga Banka Ekonomike, Pro Credit Bank, BPB Bank , TEB Bank.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, konform dispozitave nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe erdhi në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ, deklarimeve në padi dhe përgjigje padi, shkresat e lëndës, vendimi kontestues, dhe deklarimit në seancën e shqyrtimit gjyqësor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se e paditura ka caktuar kontroll tek paditësi, me ç'rast objekti i kontrollit ka qenë Tatimi mbi Vlerën e Shtuar për periudhën 01/2017 deri 08/2020, Kontributet e pronarit CI për periudhën 03/2017 deri më 12/2019 dhe Deklarata Vjetore e Tatimit në të Ardhura Personale PD për vitin 2017-2019, ku si rezultat i këtij kontrolli paditësi është ngarkuar me detyrime shtesë si në raport të kontrollit dhe me ndëshkime administrative si rezultat i mos krijimit dhe mos mbajtjes së regjistrave. Jo kontestuese mbesin

edhe faktet se paditësi ka ushtruar ankesë pranë departamentit të ankesave në ATK-së, e për të cilën ankesë ATK-ja me datë 11.11.2021 ka marr vendimin nr. prot.350/2021, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin ka refuzuar ankesën e këtui paditësit, e ndaj të cilit vendim paditësi me padinë e datës 09.12.2021 ka iniciuar këtë kontest tregtar administrativ, me të cilin ka kërkuar anulimin e pjesërishtëm të vendimet sa i përket trajtimit të huazimeve dhe deponimeve në llogaritë bankare nga ana e të paditurës.

Gjykata konstaton se vendimi i kontestuar sa i përket qarkullimi dhe tatimit shtesë, për deponimet e trajtuara me kontroll si të hyra të tatueshme, nuk përmban arsye mbi faktet vendimtare, të vlefshme për zgjidhjen e drejtë të çështjes në shqyrtim. Në realitet, në vendimin e kontestuar por edhe në raportin e kontrollit, nuk është vërtetuar drejt gjendja faktike sikurse edhe nga faktet e vërtetuar është nxjerr konkluzion jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike.

Gjykata nga gjendjet e llogarisë bankare të paditësit dhe kontratat e huazimeve me palët e treta, ka konstatuar se paditësit mjaftueshtëm ka argumentuar prejardhjen e mjeteve në llogaritë bankare, për faktin se secila e hyrë në llogaritë bankare që është bërë si huazim, edhe përshkrimin e transaksionit e ka “Huazim” dhe bashkangjitur ka kontratën e lidhur ne mes të paditësit dhe huadhënësit. Pretendimi i të paditurës së këto kontrata të huazimit nuk janë në harmoni me legjislacionin tatimor në fuqi, për gjykatën është i pabazuar pasi që baza ligjore në të cilën është mbështetur e paditura përkatësishtë, UA 02/2016 neni 3 në të cilin parashihet se “*E ardhur nga interesi në huadhënie konsiderohet çdo e ardhur e përfituar nga dhënia në formën e huas të mjeteve monetare apo mjeteve të ngjashme me to. 3.1. Për këtë kategori të të ardhurave llogaritja e detyrimit tatimor bëhet duke u bazuar në kontratën në mes palëve e cila përcakton: 3.1.1. Shumën e huas; 3.1.2. Aftin e kthimit të huas; 3.1.3. Pranimi-kthimi i huas duhet të bëhet përmes llogarive bankare; 3.1.4. Shkallën e interesit të huas duke u bazuar në vlerën e hapur të tregut; 3.2. Nëse nuk plotësohen kushtet e parapara në nënparagrafin 3.1. të këtij neni, huaja për qëllime tatimore trajtohet e ardhur për pranuesin e saj*”, përcakton interesin mbi huan vetëm për kontratat e huas të cilat lidhen me vullnetin e lirë të palëve me interes. Prandaj paragrafi 3.2 i nenit 7 të UA 02/2016, ndërlihet me paragrafin 3 të po këtij neni i cili decidivisht përcakton interesin në huadhënie nëse kontratat e tilla me vullnetin e palëve lidhen me interes, mirëpo nuk përcakton formën e përgjithshme të kontratës së huas, sepse e paditura në bazë të nenit 2 paragrafi 2 të Ligjit 03/L-222 ka kompetencë të administroj çdo lloj tatimi, por jo të përcaktoj detyrimisht formën e kontratave të huas që ato të lidhen me interes. Prandaj për gjykatën një

vlerësim i tillë nga e paditura i mbështetur në këtë bazë ligjore nuk konsiderohet i pranueshëm në rastin konkret, kur kontratat e huas në mes të paditësi dhe palëve tjera janë lidhur pa interes.

Të metat e lartcekura janë të tilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, prandaj gjykata në rivendosje e obligon të paditurën që të deklarohet se mbi bazën e cilave prova konkrete e ka ngarkuar paditësin me detyrime tatimore për periudhën e kontrollit, si janë siguruar ato provat, çka vërtetohet me ato prova, nga cili subjekt kanë rezultuar këto deponime bankare që janë trajtuar si të hyra. E paditura në rivendosje obligohet të bëjë krahasimin e gjendjes së llogarisë me ditarin e arkës së paditësi të sjell në procedurë të ankesës tek e paditura. Në ri procedurë e paditura të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t'i mënjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Vendimin që secila palë t'i bartë shpenzimet e procedurës, Gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u tha më lartë, gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 43 par.2, dhe 46 par 1, 2 dhe 3, të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal
KF.nr.497/22, datë 09.10.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.